

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE DURRËS  
NOTERE VIOLA PETANI



DATE 13/05/2024  
NR REP 1058



VËRTETIM NËNSHKRIMI


Durrës, sot më datë 13/Maj/2024, para meje Notere Viola Petani, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore Durrës, me zyrë në adresën: Durrës, lagja nr. 3, sheshi "Liria", qendra e biznesit "Best Co", katë i V-të, u paraqit:

Znj. Wenyao Yuan, atësia Shengabo Yuan, amësia Zhifen Wang, shtetase kineze, lindur në Zhejiang dhe banuese në RM 101, nr. 55 Lane 200 Songtao Road Pudong Shanghai, Kinë, lindur më 07/Tetor/1966, gjendja civile beqare, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova me Pasaportë nr. EJ8076029, lëshuar nga Republika Popullore e Kinës në datën 13/Shkurt/2023, e vlefshme deri në datën 12/Shkurt/2033.

Znj. Wenyao Yuan deklaron se ka hartuar Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë me përgjegjegjësi të kufizuar "RUBY RAINBOW" dhe i nënshkruan ato në praninë time noteres në 3 (tre) njësi origjinale.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar nëpërmjet mjetit të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005, vërtetoj nënshkrimin e saj.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



## AKT THEMELIMI

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RUBY RAINBOW"

Në Durrës, sot në datën **13/ Maj/ 2024** (Dymijë e njëzetë e katër), unë **Wenyaoyuan**, atësia Shengabo Yuan, amësia Zhifen Wang, shtetase kineze, lindur në Zhejiang dhe banuese në RM 101, nr. 55 Lane 200 Songtao Road Pudong Shanghai, Kinë, lindur më 07/Tetor/1966, gjendja civile beqare, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me Pasaportë nr. EJ8076029, lëshuar nga Republika Popullore e Kinës në datën 13/Shkurt/2023, e vlefshme deri në datën 12/Shkurt/2033,

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i azhornuar), ligjit Nr. 131-2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" etj,

**Themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "RUBY RAINBOW" sh.p.k.**

**Selia e shoqërisë është në adresën:** Durrës, Shkallnur, kati 1, apartamenti nr. 4,

**Objekti i shoqërisë është:** Konsulencë. Tregti brenda dhe jashte territorit te Republikës se Shqiperise. Ndermjetes tregtar. Agjent tregtar.

**Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është pa afat.**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (Njëqind) euro dhe përbëhet nga 1 kuotë me 100 % pjesemarrje ne kapitalin themeltar dhe zotërohet nga unë ortaku themelues Wenyaoyuan.**

Shoqëria do te shtrije aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqiperisë. Me vendim të asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijojen ose anullohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

#### Administrimi i shoqërisë

**Administrator i shoqërisë emërohet znj. Wenyaoyuan**, e cila pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

**Afati i emërimit të administratorit është 5 vjet.** Administratori emërohet sot në datën e nenshkrimit. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Biznesit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare).

Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transkaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, keto do te realizohen vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme, me shitje, dhurim, në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare dhe ne menyra te tjera te parashikuara nga Kodit Civil dhe ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Ortaku gëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazën e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me nga dy faqe secila, në gjuhën shqipe, me përbajtje e vlera të njëjtë juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga ortaku themelues dhe nënshkruhet prej tij në çdo faqe.

#### **ORTAKU THEMELUES I "RUBY RAINBOW" sh.p.k**

*Yuan Wenyaoyuan*

## STATUT

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "RUBY RAINBOW"

Në Durrës, sot në datën **13/ Maj/ 2024** (Dymijë e njëzetë e katër), unë **Wenyaoyuan**, atësia Shengabo Yuan, amësia Zhifen Wang, shtetase kineze, lindur në Zhejiang dhe banuese në RM 101, nr. 55 Lane 200 Songtao Road Pudong Shanghai, Kinë, lindur më 07/Tetor/1966, gjendja civile beqare, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me Pasaportë nr. EJ8076029, lëshuar nga Republika Popullore e Kinës në datën 13/Shkurt/2023, e vlefshme deri në datën 12/Shkurt/2033,

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i azhornuar), ligjit Nr. 131-2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" etj,

hartoj statutin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar te "RUBY RAINBOW" sh.p.k si vijon:

#### Emërtimi

Themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar **emërtuar "RUBY RAINBOW" sh.p.k.**

#### Selia

**Selia e shoqërisë është në adresën:** Durrës, Shkallnur, kati 1, apartamenti nr. 4,

#### Objekti

**Objekti i shoqërisë është:** Konsulencë. Tregti brenda dhe jashte territorit te Republikës se Shqiperise. Ndermjetes tregtar. Agjent tregtar

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është pa afat.

#### Kapitali

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (Njëqind) Euro, i përbërë nga 1 kuotë me 100 % pjesemarrje ne kapitalin themeltar dhe zotërohet nga unë ortaku themelues Wenyaoyuan.**

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para' ose në natyrë (pasuri e luajtshme dhe/ ose e paluajtshme, apo të drejta reale). Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontributet në shërbime.

Ortaku per gjigjet për humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve duke respektuar të njëjtat kushte dhe kriteri që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpëra datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të thirrur për të marrë vendim rrithë këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale ligjore të përcaktuar. Në të kundërt shoqëria duhet të shndërrohet në një formë tjeter.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i kapitalit prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata përfaqësojnë.

## Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitat të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin rej tyre mund të fitohet apo kalohen nëpërmjet

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- Shitjes
- Trashëgimisë
- Dhurimit
- Çdo mënyrë tjetër të parashikuar në Ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

## Organ Vendimmarres

Asambleja e ortakëve është i vetmi organ vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e Vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme :

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- Ndryshimet e statutit
- Emërimin / shkarkimin e administratorit/ëve dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre.
- Emërimin / shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave proçedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e përgjithshme.

## Mënyra e thirrjes

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 pér qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të kësaj tij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## Marrja e vendimeve

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" pér :

- ndryshimin e statutit,
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar,
- shpërndarjen e fitimeve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, pér çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë Q.K.B pér të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Administrimi i shoqërisë

**Administrimi i shoqërisë i është besuar personit Menyao Yuan**, atësia Shengabo Yuan, amësia Zhifen Wang, shtetasse kineze, lindur në Zhejiang dhe banuese në RM 101, nr. 55 Lane 200 Songtao Road Pudong Shanghai, Kinë, lindur më 07/Tetor/1966.

**Afati i emëritit të administratoreve është 5 vjet.** Administratori emërohet sot në datën e nenskrimit te kontrates. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombetare të Biznesit (Neni 95, pika e parë e Ligjt Nr. 9901, date 14/04/2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare)

Administratori përfaqëson, në mënyrë të pavarur, shoqërinë tregtare, kryejnë veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

Ne rastet e kryerjes së veprimitave të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transkaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Një person, i cili është, njëkohësisht, administrator dhe ortak apo aksionar i vetëm i shoqërisë, nuk mund të lidhë kontrata huaje apo garancie me shoqërinë

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me vendim unanim.



## **Administratori ka të drejtë e detyrohet të:**

- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatise dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit
- raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

## **Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme në rastet e mëposhtme :**

- Nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

## **Përgjegjësitë e administratorit:**

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë dhe / ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjit, për shkelje të statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Administratori gjatë kryerjen së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare me përjashtim të rasteve kur pas hetimit dhe vlerësimit rezulton se administratori ka qenë në mirëbësim.

## **Administratori detyrohet të :**

- Të ushtrojë kompetencat e tij të parashikuara në Ligj dhe në statut
- Të parandalojë dhe të mënjanojë rastet e konfliktit të interesave personale me ato të shoqërisë.
- Të vlerësojë me përgjegjësi Çështjet për të cilat merret vendim ...etj

## **Viti finanziar – ekspertët**

Viti finanziar i shqërisë fillon në datën një Janar dhe përfundon në datën Tridhjetë e një Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike – tregtare të shoqërisë, kontrollet periodike etj.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

## **Shkaqet e prishjes së shoqërisë :**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit Nr. 131-2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit.  
d) me vendim të gjykatës.  
dh) për arsyet e tjera, të parashikuara në statut.

### Regjistrimi i shpërbërjes

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit Nr. 131-2015 Për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje ligjit Nr. 131-2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" i'a njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.

### Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi/ ndarja

Një shoqëri mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjeter, nëpërmjet ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose nëpërmjet shndërrimit të formës ligjore; në çdo rast sipas Vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së ortakëve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë trgtare"

Shoqëritë mund të riorganizohen vetëm pasi kanë qenë të regjistruara për të paktën një vit.

Bashkimi i shoqërive kryhet në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e konkurrencës.

### Dispozita përfundimtare

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar në tërësi. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë trgtare", Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe i gjithë legjisacioni shqiptar në tërësi.

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata shqiptare.

Ky Statut redaktohet në tre njësi origjinale, me nga gjashtë faqe secila, me përbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga ortaku themelues dhenënskruhet prej tij në çdo faqe.

### **ORTAKU THEMELUES**

**TË "RUBY RAINBOW" SH.P.K**

*Yuan Wangao*  
*王芳*